

---

TRAJNIM

# AUDITOR I ÇERTIFIKUAR I SEKTORIT PUBLIK

---

AFATI JANAR-SHKURT, 2021



## **1. Plan-programi i aprovuar dhe kërkesat për marrjen e thirrjes Auditor Çertifikuar i Sektorit Publik (AÇSP)**

Plan-programi për Auditor të Çertifikuar të Sektorit Publik është zhvilluar në bashkëpunim me CIPFA (në kuadër të së cilit është bërë fuzionimi i programit të përbashkët ShKÇAK-ZAP), program i aprovuar nga Këshilli i ShKÇAK dhe Komisioni i Edukimit. Plan-programi si dhe kërkesat tjera për çertifikim janë përshtatur bazuar në programin çertifikues të ShKÇAK të sektorit privat në bashkëpunim me CIPFA.

### ***1.1. Kërkesat për ta fituar thirrjen 'Auditor i Çertifikuar të Sektorit Publik'***

- *Edukimi universitar*: kandidatët duhet të kenë të kryer së paku një fakultet të nivelit baqelor.
- *Edukimi profesional*: kandidatët duhet të kenë ndjekur trajnimin profesional të këtij programi dhe duhet të kenë kryer të gjitha provimet e parapara.
- *Përvoja praktike*: kandidatët duhet të kenë së paku 3 vite përvojë pune në sektorin publik në financa, auditim ose në ndonjë pozitë ekuivalente. Përvoja praktike mund të realizohet para ose pas regjistrimit në programin çertifikues por thirrja mund të fitohet vetëm pas arritjes së të gjitha kërkesave të programi çertifikues.
- *Kodi i etikës*: kandidatët duhet të respektojnë kërkesat e Kodit të Etikës të IFAC/FNK.

### ***1.2. Kërkesat për edukim të vazhdueshëm profesional (EVP)***

Të gjithë anëtarët e ShKÇAK do të plotësojnë kërkesat minimale për EVP në mënyrë që të ruajnë kompetencat e tyre personale dhe profesionale. Kjo është e rëndësishme për veten e tyre, klientët e tyre dhe punëdhënësit, si dhe për vetë ShKÇAK.

Përmbushja e programit EVP do të mundësojë kredibilitet të zgjeruar për *Auditorin e Çertifikuar të Sektorit Publik* duke siguruar përmirësimin e vazhdueshëm të aftësive. Në këtë drejtim, Auditori i Çertifikuar duhet:

- Të plotësojë së paku 40 orë të EVP-së gjatë vitit prej të cilave 24 orë duhet të jenë të verifikueshme. Aktivitetet do të regjistrohen në kartën e regjistrimit të EVP-ve të ShKÇAK-së për periudhën përkatëse të çdo viti; dhe

- Duhet të dorëzojnë kartën e regjistrimit të plotësuar së bashku me dëshmi mbështetëse, sipas afatit të përcaktuar.

Edukimi i Vazhdueshëm Profesional (EVP) mund të përfshijë:

*EVP Azhurnuese:* Ofron kompetencë profesionale dhe parandalon mos-informimin nga më të rejat e profesionit nga anëtarët të cilët mund të jenë të kufizuar nga zona ku anëtari punon.

*EVP Zhvilluese:* Ofron njohuri të reja, zgjeron aftësitë dhe hap mundësi të reja për zhvillim brenda profesionit.

Temat e EVP-ve të verifikueshme do të propozohen nga Komisioni i Edukimit i ShKÇAK-së.

Përveç EVP-ve të ofruara nga ShKÇAK, EVP-të e ofruara dhe organizuara nga ZAP, MF dhe organizata të ndryshme ndërkombëtare profesionale do të konsiderohen si relevante për përmbushjen e orëve minimale të nevojshme të EVP-së.

### 1.3. Edukimi profesional dhe provimet

Një nga parakushtet për tu certifikuar si Auditor i Çertifikuar i Sektorit Publik është edhe ndjekja e edukimit profesional si dhe kalimi i provimeve të listuara në vijim.

*Lëndët e skemës së certifikimit për Auditor të Çertifikuar të Sektorit Publik*

<b>Teknik i Kontabilitetit</b>	<b>Auditor i Çertifikuar i Sektorit Publik</b>
P1/Kontabiliteti financiar	S1/Menaxhmenti Financiar dhe Buxhetimi
P2/Kontabiliteti menaxherial	S2/Raportimi Financiar i Sektorit Publik
P3/Kontabilisti në biznes	S3/Financat Publike dhe Sistemi Informativ
P4/Ligjet dhe tatimet në Kosovë (ligjet nacionale)	S4/Planifikimi Strategjik dhe zhvillimi i politikave (ri-emërim nga Analizat e Biznesit)
	S5/Qeverisja, Rreziku dhe Kontrolli
	S6/Metodologjia e Auditimit

Nëpërmjet këtij programi, kandidatët do të fitojnë një certifikim të njohur ndërkombëtarisht, certifikatë të akredituar në Kosovë dhe certifikatë në Angli të lëshuar nga CIPFA. Kjo gjithashtu do t'u mundësojë kandidatëve të kenë anëtarësi të dyfishtë në të dy shoqatat profesionale.

#### ***1.4. Tarifat për trajnime, provime, anëtarësi dhe EVP***

**Pagesa për Teknik të Kontabilitetit** për pjesëmarrje në ligjëratë e cila përfshinë librin dhe trajnimin është 100€ dhe pagesa për provim është 30€.

**Pagesa për Auditor i Çertifikuar i Sektorit Publik** për pjesëmarrje në ligjëratë e cila përfshinë librin dhe trajnimin është 250€ dhe pagesa për provim është 50€.

**Tarifa e anëtarësisë** është sipas këtyre kategorive të titujve:

- Studentë - 60€
- Teknik i Kontabilitetit - 84€
- Auditor i Çertifikuar i Sektorit Publik - 144€

**Tarifa për EVP-të** e organizuara nga ShKÇAK është 7.5€/orë për anëtarët aktiv dhe 15€ për anëtarët jo-aktiv si dhe për publikun e gjerë.